AKT NORMATIV
Nr.5, datë 28.12.2005

PËR DËRGIMIN E PERSONELIT USHTARAK SHQIPTAR, NË PËRBËRJE TË SHTABIT TË SEEBRIG-UT, NË MISIONIN E MBËSHTETJES SË PAQES (ISAF), NË AFGANISTAN, TË DREJTUAR NGA NATO

Në mbështetje të neneve 12, pika 3 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Dërgimin e personelit shqiptar, prej 9 ushtarakësh, në përbërje të shtabit të SEEBRIG-ut, në Misionin e Mbështetjes së Paqes (ISAF), në Afganistan, të drejtuar nga NATO.

Neni 2

Ministria e Mbrojtjes të përballojë efektet financiare për kontributin e Republikës së Shqipërisë në dislokimin, përdorimin dhe ridislokimin e shtabit të SEEBRIG-ut, në Misionin e Mbështetjes së Paqes, ISAF, nga Konstanca e Rumanisë në Kabul të Afganistanit.

Neni 3

Ushtarakët shqiptarë, në përbërje të shtabit të SEEBRIG-ut, për ditët e qëndrimit në mision, në Afganistan, përveç pagës mujore, të marrin, për vështirësi shërbimi, dhe një shpërblim ditor, në masën, që do të caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 4

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha